



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201800949/5

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandim për rivendosjen në vend të të drejtës ligjore të shkelur punonjësës së policisë G.A.(M.)*

Drejtuar : **Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit**
Drejtues Madhor Ardi VELIU

Tiranë

I nderuar zoti Veliu,

Me shkresën nr. K2/G12-3 Prot., datë 04.06.2018, ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja G.A.(M), punonjëse e Policisë së Shtetit. Ankuesja shkruan se ka qënë me shërbim në Komisaratin e Policisë Aeroporti Rinas dhe në datën 13.11.2017 ka marrë lejen e lindjes. Pas lindjes së fëmijës dhe gjatë periudhës kohore që ka qënë me lejen e lindjes, në datën 23.01.2018, është njoftuar nga eprorët e saj se ishte transferuar në Komisaratin e Policisë nr. 4 Tiranë. Ankuesja pretendon se, sipas Kodit të Punës nuk lejohet transferimi dhe pushimi nga puna i grave gjatë periudhës që janë me lejen e lindjes. Sipas saj, nga ky transferim i padrejtë i është shkaktuar jo vetëm një dëm emocional (moral), por edhe një dëm ekonomik për shkak të largësisë në vëndin e ri të punës, sepse ajo është me banim në Fushë Krujë. Gjithashtu pasi të fillojë punën në vëndin e ri të punës, në Komisaratin e Policisë nr. 4 Tiranë, ajo do ta ketë të vështirë që të përkujdeset për fëmijën e saj, si për shkak të largësisë nga vëndi i banimit, ashtu edhe për faktin e kohës së punës me tre turne.

Në bazë të kërkesës tonë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 499/1-G, datë 19.06.2018, ndërmjet të tjerave na ka informuar se, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin, me shkresën nr. 4/1, datë 09.1.2018, me qëllim përmirësimin e rezultateve të punës në strukturat vendore të Policisë Kufitare dhe Migracionit, sipas kompetencës ligjore, propozoi transferimin e disa punonjësve të policisë. Për sa më sipër, Inspektore G.M., me urdhrin nr. 78, datë 11.01.2018 është transferuar nga detyra Ndihmës specialist, kontrollore në Seksionin e Kufirit në Komisaratin e Policisë Kufitare Aeroporti Rinas, në Drejtorinë Vendore të Kufirit Tiranë, me detyrë në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Aktualisht ajo është me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme, trupë shërbimi, në Seksionin e Patrullës së

Përgjithshme, në Komisarlatin e Policisë nr. 4 Tiranë, në funksion korrespondues të gradës që mban dhe në kushtet të njëjta në drejtim të ruajtjes së shëndetit të nënës dhe të fëmijës.

Avokati i Popullit si një institucion kombëtar dhe kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut monitoron zbatimin e detyrimeve ligjore të organeve të administratës publike ndaj shtetasve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nxitur nga ky rast, Avokati i Popullit sjellë në vëmendje se, gratë shtatzëna dhe nënat e reja gëzojnë mbrojtje të plotë dhe të veçantë ligjore nga legjislacioni i brendshëm, si dhe nga aktet ndërkombëtare, të cilat pas ratifikimit nga shteti shqiptar janë bërë pjesë e të drejtës tonë të brendshme, disa prej të cilave po i përmëdim më poshtë:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 54 pika 1 parashikon se:

“Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti”.

2. Deklarata mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave, shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 7 Nëntor 1967 (rezoluta 2263 (XXII)), në nenin 10 pika 2 parashikon se:

“Me qëllim që të ndalohet diskriminimi ndaj grave për shkaqe martesore apo lindjeje dhe për t’u siguruar atyre të drejtën efektive për punë, duhen marrë masa për të mos lejuar pushimin e tyre nga puna në raste martesore ose lindjeje fëmijësh. Po ashtu të parashikohen për ato lejet e lindjes të paguara, të shoqëruara me garancinë e kthimit në punën që kanë pasur”

3. Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), miratuar dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe aderim nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën e saj 34/180 të 18 Dhjetorit 1979, hyrë në fuqi më 3 Shtator 1981, ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 1769, datë 09.11.1993, në nenin 11 pika 2 parashikon se:

“Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkak martesore ose materniteti, ose edhe për të garantuar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë zotohen të marrin masa të përshtatshme që të kenë për efekt:

a) *Moslejimin e pushimit nga puna për shkaqe shtatzanie apo të lejes së barrës, si dhe diskriminimin në raste të pushimit nga puna të bazuar në gjëndjen martesore, duke parashikuar për të gjitha këto edhe sanksione kundër shkelësve;*

b) *Vendosjen e akordimit të lejes së barrës të paguara ose të drejtës për të fituar ndihma sociale të krahasueshme, të shoqëruara me garancinë e ruajtjes së vendit të punës të mëparshme, të të drejtave të vjetërsisë dhe të avantazheve sociale”.*

4. Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 105 pika 4 parashikon se:

“Me mbarimin e lejes së lindjes, punëmarrësi ka të drejtë të kthehet në vendin e punës ose në një vend punë të barasvlefshëm, në kushte që nuk janë më pak të favorshme për të, si dhe të përfitojë çdo përmirësim të kushteve të punësimit që do të kishte përfituar gjatë mungesës”.

5. Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, në nenin 64 (Kujdesi për gratë shtatzëna) parashikon se:

“1. Punonjëset e policisë shtatzëna ose më fëmijë në gji nuk mund të punësohen në punë ose shërbime që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës.

2. Nuk lejohet puna e natës për punonjëset e policisë shtatzëna.

3. Këshilli i Ministrave cakton sektorët e shërbimeve policore që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës, rregullat e veçanta për kushtet e punës për punonjëset e policisë që janë shtatzëna, si dhe rastet kur lejohet puna e natës për punonjëset e policisë dhe nënat me fëmijë në gji.”

Ndërsa në neni 65 (Leja e lindjes) të këtij ligji parashikohet se:

“1. Punonjëset e policisë shtatzëna gëzojnë të drejtën e lejes së paralindjes dhe paslindjes, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Të ardhurat që përfitohen në rast leje lindjeje, përcaktohen nga ligji për sigurimet shoqërore.”

6. Rregullorja e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 19.09.2015 në nenin 63 (Mbrojtja e grave shtatzëna) parashikon se:

“1. Punonjëset e Policisë shtatzëna nuk mund të punojnë në punë të rënda ose të rrezikshme që dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës.

2. Pas përfundimit të lejes së lindjes ose ndërprerjes së saj, punonjësja ka të drejtë të kthehet në të njëjtin vend pune.....”

Nga përmbajtja e akteve normative të cituara më sipër rezulton se, gjatë lejes së lindjes punëmarrësi nuk mund të transferohet nga vendi i punës. Ndërsa pas mbarimit të lejes së lindjes, ai edhe mund të transferohet nga punëdhënësi por në një vend pune të barasvlefshëm dhe me kushte jo më pak të favorshme për të.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së shtetases G.A.(M.) kemi konstatuar se, transferimi i saj nga detyra Ndhmës specialist, kontrollore në Seksionin e Kufirit në Komisaratin e Policisë Kufitare Aeroporti Rinas, në Drejtorinë Vendore të Kufirit Tiranë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme, trupë shërbimi, në Seksionin e Patrullës së Përgjithshme, në Komisaratin e Policisë nr. 4 Tiranë, pavarësisht të faktit se është në funksion korrespondues të gradës që mban, është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me aktet normative të cituara më sipër. Kundërligjshmëria e transferimit të saj qëndron në faktin se:

Së pari, është bërë në kohën e papërshtatshme, gjatë kohës që ajo ka qënë me raport leje lindjeje, duke iu cënuar rëndë garancia ligjore e ruajtjes së vendit të punës të mëparshme.

Së dyti, është bërë në një vend pune me kushte më pak të favorshme nga ai që kishte para marrjes së lejes së lindjes së fëmijës, sepse është shumë më larg vendbanimit të saj Fushë Krujë. Kjo largësi e vendit të ri të punës do të ndikojë në uljen e mundësisë të kujdesjes së saj me cilësinë e nënës së re për fëmijën e mitur, sepse do të harxhojë më shumë kohë për vatje-ardhjet nga puna, Fushë Krujë - Komisarati i Policisë nr. 4 Tiranë. Gjithashtu asaj do ti duhet të bëjë më shumë shpenzime financiare për transportin nga vendbanimi në vendin e ri të punës, që do të ndikojë dukshëm në uljen e nivelit të jetesës së saj dhe të familjes së vet.

Sjellim në vëmendje se, nëse nevojat e punës në Komisaratin e Policisë Kufitare Aeroporti Rinas do të kërkonin plotësimin e vendit të punës së ankueses, atëherë nga ana juaj duhet të zbatohet neni 181 i Rregullores së Policisë së Shtetit (Rastet e transferimit të përkohshëm) ku parashikohet se:

“1. Punonjësi i Policisë transferohet përkohësisht në një detyrë tjetër, për nevoja pune, në rastet e mëposhtme:

1.1. Për zëvendësimin e një punonjësi të Policisë, kur:

a) punonjësi i Policisë është me raport mjekësor të zgjatur;

b) punonjësja e Policisë është me raport leje lindje.”

Për sa më sipër dhe me qëllim rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ankueses, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për revokimin e urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 78, datë 11.01.2018 për transferimin e Inspektores G.M., me detyrë Ndhimës specialist, kontrollore në Seksionin e Kufirit në Komisarriatin e Policisë Kufitare Aeroporti Rinas, në Drejtorinë Vendore të Kufirit Tiranë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë me detyrë Oficer i Patrullës së Përgjithshme, trupë shërbimi, në Seksionin e Patrullës së Përgjithshme, në Komisarriatin e Policisë nr. 4 Tiranë.

2. Në pamundësi të rikthimit të saj në Komisarriatin e Policisë Kufitare Aeroporti Rinas, të gjendet një zgjidhje alternative duke marrë konsensusin e ankueses për t'u emëruar në një detyrë në përputhje me gradën që mban dhe organ i cili ndodhet sa më pranë vendbanimit aktual.

3. Mos përsëritjen e rasteve të tilla të shkeljes së të drejtave punonjëseve të policisë të cilat janë me raport leje lindjeje.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi na vini në dijeni brenda afati ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI